



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2017

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mars 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMbledhje Ekzekutive	6
KORNIZA Ligjore	7
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	7
<i>Misioni i KPM-së është:</i>	7
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL.....	7
<i>Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së</i>	7
<i>Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2017</i>	8
<i>Nominimet e anëtarëve të KPM-së</i>	8
AKTIVITETET E KPM-së.....	9
HARMONIZIMI I TEKSTIT TË STRATEGJISË PËR KALIM NË TRANSMETIM DIGJITAL ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV Nr. 02/2012.....	15
HARTIMI DHE AMANDAMENTIMI I AKTEVE NËNLIGJORE.....	16
<i>Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së</i>	17
RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT	17
ORGANIZIMI I TAKIMEVE REGJIONALE ME MEDIA.....	17
MONITORIM I MEDIAVE GJATË ZGJEDHJEVE NACIONALË DHE ZGJEDHJEVE LOKALE 2017.....	18
<i>Monitorimi gjatë fushatës për zgjedhjet nacionale 2017</i>	19
<i>Monitorimi gjatë fushatës për zgjedhjet lokale 2017 (raundi i parë dhe i dytë)</i>	19
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	20
<i>Bashkëpunimi me Misionin Vëzhgues nga Bashkimi Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve</i>	20
<i>Bashkëpunimi në kuadër të platformës evropiane të autoriteteve rregullatore (EPRA)</i> ..	20
<i>Bashkëpunimi në kuadër të rrjetit mediteran të autoriteteve rregullatore (MNRA)</i>	21
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE	22
<i>Burimet njerëzore</i>	22
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE (DMA)	23

<i>Monitorimi i Mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjeve të Përgjithshme dhe Lokale 2017 në Republikën e Kosovës.....</i>	<i>23</i>
<i>Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së – Pjesa 3 e Licencës</i>	<i>24</i>
<i>Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit</i>	<i>25</i>
<i>Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2017/06 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale</i>	<i>25</i>
<i>Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale.....</i>	<i>25</i>
<i>Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.....</i>	<i>26</i>
<i>Monitorimi i edicioneve qendrore të lajmeve</i>	<i>26</i>
<i>Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së Operatorëve të Shpërndarjes</i>	<i>27</i>
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	28
<i>Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës.....</i>	<i>28</i>
<i>Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhës kryesore në të cilën transmetojnë:</i>	<i>28</i>
<i>Numri Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:</i>	<i>29</i>
<i>Ofruesit e Shërbimeve Mediale Adio dhe adiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes.....</i>	<i>29</i>
<i>Shqyrtimi i kërkesave</i>	<i>29</i>
DEPARTAMENTI LIGJOR.....	30
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit Vjetor</i>	<i>30</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM - 2013/03</i>	<i>30</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01</i>	<i>31</i>
<i>Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës</i>	<i>31</i>

<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2014/03 - Mos pagesa e taksës për licencë</i>	<i>32</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01</i>	<i>32</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për të Drejtën e autorit KPM 2013/02.....</i>	<i>32</i>
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 48, nenit 49, paragrafit 6 dhe 7, nenit 52, paragrafit 1, si dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, nenit 9 paragrafit 7.....</i>	<i>32</i>
<i>Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03.....</i>	<i>33</i>
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR	35
<i>Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....</i>	<i>35</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....</i>	<i>36</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)</i>	<i>36</i>
<i>Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal</i>	<i>37</i>
<i>Rastet për interferenca.....</i>	<i>37</i>
<i>Rastet për transmetime të pa licencuara</i>	<i>38</i>
<i>Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR</i>	<i>38</i>
<i>Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit</i>	<i>38</i>
<i>Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë</i>	<i>39</i>
<i>Kërkesë për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja</i>	<i>39</i>
<i>Plani frekuencor dhe digjitalizimi</i>	<i>39</i>
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE	39
<i>Buxheti</i>	<i>39</i>
PUNA E BORDIT PËR ANKESA.....	42
<i>Emërimi i një anëtari të Bordit për Ankesa</i>	<i>42</i>
<i>Përbërja e Bordit gjatë vitit 2017.....</i>	<i>42</i>
<i>Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa</i>	<i>42</i>

OBJEKTIVAT E VITIT 2017	44
OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2018	44
REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT	46
<i>Problemet me buxhetin</i>	46
<i>Nevoja për punëtorë të rinj</i>	46
AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2016.....	46
Rekomandimet nga Raporti i Auditimit të ZAP-it.....	52

SHTOJCAT

Shtojca I	Organogrami
Shtojca II	Tabela e Rasteve Ligjore
Shtojca IIIa	Raporti Vjetor Financiar
Shtojca IIIb	Raporti Vjetor Financiar
Shtojca IV (a, b, c, d)	Raportet e monitorimit të mediave gjatë zgjedhjeve nacionale dhe lokale 2017

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky është raporti me aktivitetet e Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2017, të cilin ju përcjellim në pajtim me Ligjin Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ashtu siç kërkohet nga Kuvendi, raporti është i ndarë në kapituj ku është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësi të KPM-së.

Raporti i punës së KPM për vitin 2017, përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, amandamenti/miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i KPM-së me të licencuarit, bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi me rregullatorët në rajon e më gjerë. Po ashtu, në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele të licencuara nga KPM-ja, me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, statistikën e numrit të të licencuarve, rastet ligjore të proceduara, shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës, raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak.

Edhe për vitin 2018, prioriteti i KPM-së mbetet implementimi i procesit të dixhitalizimit sipas Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjit Nr.05/1-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore, zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, harmonizimi i akteve nënligjore dhe hartimi i akteve të reja nënligjore që rrjedhin si obligim nga procesi i dixhitalizimit, në harmoni me rregullativën evropiane si dhe zhvillimi i politikës së transmetimit.

Mars 2018

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

KORNIZA LIGJORE

KPM është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Me nenin 3, paragrafin 2.8 të Ligjit për KPM-në përcaktohet që: *“KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”*.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

Misioni i KPM-së është:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele;
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11 pika 2.1. të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: *“brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”*.

Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2017

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Adnan	MEROVCI	Kryetar ¹	19 mars 2014	mandat 4 (katër) vjeçar
Abit	HOXHA	Nënkryetar ²	28 prill 2016	mandat 2 (dy) vjeçar
Anita	MORINA-SARAÇI	Anëtare	28 prill 2016	mandat 2 (dy) vjeçar
Jelena	SIMIQ	Anëtare	12 mars 2015	mandat 3 (tre) vjeçar
Mejdin	SALIJI	Anëtar	12 mars 2015	mandat 3 (tre) vjeçar
Xhemajl	KRASNIQI	Anëtar	17 nëntor 2016	mandat 4 (katër) vjeçar
Vlorë	BERISHA	Anëtare	30 nëntor 2017	mandat 3 (tre) vjeçar

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet me short në bazë të nenit 13, paragrafit 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Nominimet e anëtarëve të KPM-së

Bazuar në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM ka bërë ftesë publike për nominime për një anëtarë të KPM-së. Ftesa publike është bërë më 19 janar 2017 deri më 6 shkurt 2017. Gjatë kësaj periudhe KPM ka pranuar gjithsejtë shtatë (7) nominime. Të gjitha nominimet e pranuar, sipas procedurës më 7 shkurt 2017 KPM i ka përcjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Bazuar Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.05-V-460 dhe në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM ka bërë ftesë publike për nominime për një anëtarë të KPM-së. Ftesa publike është bërë më 27 prill 2017 deri më 16 maj 2017. Gjatë kësaj periudhe KPM ka pranuar gjithsejtë pesë (5) nominime. Të gjitha nominimet e pranuar, për shkak të shpërbërjes së Kuvendit nuk kanë mundur të dorëzohen në Kuvend sipas procedurës. Pas konstituimit të legjislaturës së re të Kuvendit, janë dorëzuar nominimet. Ndërsa pas procedurave të përzgjedhjes dhe votimit, Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e datës 30 nëntor 2017, ka emëruar anëtarin e 7 të KPM-së, me çka edhe është kompletuar përbërja e KPM-së.

¹ z. Adnan MEROVCI është ri-zgjedhur Kryetar i KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 9 mars 2016

² z. Abit HOXHA është zgjedhur Nënkryetar i KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 4 tetor 2016.

AKTIVITETET E KPM-së

Në kuadër të aktivitetit institucional dhe në bazë të obligimeve ligjore, gjatë vitit 2017 KPM-ja ka mbajtur katërmëdhjetë (14) mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për KPM-në të cilat janë të paraqitura në këtë raport.

Më poshtë në mënyrë kronologjike janë të paraqitura mbajtja e mbledhjeve dhe marrja e vendimeve nga KPM-ja.

Më 19 janar 2017, KPM ka mbajtur mbledhjen e parë për vitin 2017, ku në këtë mbledhje ka miratuar 5 akte nënligjore, si obligim që ka rrjedh nga Ligji Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore:

- Rregullore për Renditjen Logjike të Kanaleve;
- Rregullore për Bartjen e Detyrueshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale në Operatorin e Multipleksit;
- Rregullore për Operatorin e Multipleksit në Nivel Shtetëror;
- Rregullore për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, dhe
- Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë;

Detajet tjera më të hollësishme për pjesën e miratimit të rregulloreve do të sqarohen tek hartimi dhe amandamentimi i legjislacionit.

Më 8 shkurt 2017, KPM ka mbajtur mbledhjen e dytë me radhë për vitin 2017. Pas miratimit të rregulloreve të reja për procesin e dixhitalizimit një muaj më parë, KPM ka iniciuar procedurat për përgatitjen e materialit tenderues për dhënien në shfrytëzim të dy Multipleksëve, sipas përcaktimeve ligjore të dhëna në Ligjin Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore. Pas përgatitjes së materialit tenderues, KPM do të nxjerr vendimin për shpalljen e tenderit publik për kanalet 46 dhe 58, siç përcaktohet në Shtojcën e Ligjit Nr. 05/L-027.

Më 15 mars 2017, KPM ka mbajtur mbledhjen e tretë me radhë ku ka shqyrtuar tri (3) raste të licencimit dhe ka miratuar kërkesat për licencë të dy kandidatëve për të ofruar shërbime mediale udio-vizuale, OSHMA SPIN TV dhe UBT TV si dhe kërkesën e kandidatit ARTMOTION për t'u licencuar si operator i shpërndarjes IPTV.

Më 30 mars 2017, KPM ka mbajtur mbledhjen e katërt me radhë dhe ka miratuar Raportin Vjetor për periudhën kohore janar-dhjetor 2016, i cili i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtueshmëri me nenin 3 paragrafi 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Mbledhjen e pestë për këtë vit KPM e ka mbajtur më 14 prill 2017, ku ndër të tjera ka diskutuar për procesin e punës në hartimin dhe përgatitjen e kriterëve të pakos së dokumentacionit për tenderin e multipleksit. Gjithashtu në këtë mbledhje KPM ka miratuar këto vendime në 6 raste të licencimit:

1. Radio K – Kërkesë për ndryshim të lokacionit të transmetuesit dhe emrit
2. Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel Pozitiv Gold TV – Kërkesë për licencë të OSHMA
3. Radio Dukagjini – Kërkesë për frekuencë shtesë
4. Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel Pozitiv Pro Channel – Kërkesë për heqje dorë nga licenca
5. Platformë OTT Vista SHPK - Kërkesë për licencë të operatorit të shpërndarjes
6. Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel TV Llapi – Kërkesë për licencë.

KPM ka mbajtur mbledhjen e gjashtë me radhë për këtë vit më 18 maj 2017.

Në këtë mbledhje janë marrë këto vendime për miratimin e kërkesave në 2 raste të licencimit:

1. Platformë IPTV TelCos – Kërkesë për licencim si operator i shpërndarjes së shërbimeve mediale audiovizuele;
2. Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel TV7 – Kërkesë për licencë.

KPM ka mbajtur mbledhjen e shtatë më 31 maj 2017, ku ka shqyrtuar punën në lidhje me kriteret e përcaktuara në draft dosjen e tenderit publik për lejimin e dy MUX-ave. Pastaj është diskutuar lidhur me përgatitjet për procesin e monitorimit të medieve në fushatën e zgjedhjeve të parakohshme nacionale të 11 qershorit.

Në mbledhjen e tetë të mbajtur më 27 qershor 2017, KPM ka shqyrtuar raportin e monitorimit të mediave gjatë fushatës zgjedhore, respektivisht për ecurinë e procesit të monitorimit dhe vështirësitë e hasura gjatë këtij procesi si dhe të gjeturat e KPM gjatë këtyre monitorimeve. Gjithashtu në këtë mbledhje KPM ka miratuar këto vendime në 3 raste të licencimit:

1. Radio Omega – kërkesë për ndërrim pronësie
2. Radio Fokusi – kërkesë për ndërrim pronësie
3. Labia TV – kërkesë e për licencim si operator i shpërndarjes së shërbimeve mediale audiovizuele.

Mbledhjen e nëntë për këtë vit KPM e ka mbajtur më *1 gusht 2017*. Në këtë mbledhje KPM ka shqyrtuar rastet ligjore të shkeljeve që janë evidentuar nga monitorimi i ofruesëve të shërbimeve mediale audiovizuale. KPM ka marrë vendime me masën sanksionuese *Vërejtje* dhe sanksione me gjobë për këto raste:

1. RTV Dukagjini – Shkelja e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale/ ankesa e Blerina Lubishtani
2. RTV Dukagjini – Shkelja e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale/ ankesa e Adelina Reçica – masë sanksionuese gjobë 2000 euro
3. RTV Dukagjini – Shkelja e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale/ ankesa e Blerim Devolli – masë sanksionuese gjobë 2000 euro
4. Rrokum TV – Shkelja e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale
5. Klan Kosova – Shkelja e Rregullores për të Drejtën Autorit
6. TV Ballkan – Shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës
7. Radio Rinia – Shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës
8. TV Besa – Shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës
9. TV Festina – Shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës
10. TV Iliria – Shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës
11. ART Motion – Shkelja e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale
12. IPKO – Shkelja e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale
13. Kujtesa – Shkelja e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale
14. MAX TV – Shkelja e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale
15. Kadria Net – Shkelja e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale
16. Telekom i Kosovës – Shkelja e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Ndërsa nga monitorimi i zgjedhjeve të përgjithshme të 11 qershorit, për ato shërbime mediale audiovizuale që kanë kryer shkelje të legjislacionit, respektivisht kanë vepruar në kundërshtim me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. KPM ka ka iniciuar raste ligjore, të cilat i ka shqyrtuar Komisioni në këtë mbledhje. Pas shqyrtimit, Komisioni mori vendimet me masën sanksionuese *Vërejtje*, për këto raste:

- | | |
|--------------------|---------------|
| 1. Klan Kosova | 9. TV Most |
| 2. Tribuna Channel | 10. TV Puls |
| 3. TV Dukagjini | 11. TV Mir |
| 4. TV Opnion | 12. TV Kim |
| 5. TV Vali | 13. RTK 1 |
| 6. TV Syri Vision | 14. Rrokum TV |
| 7. TV 21 | 15. TV Besa |
| 8. TV Herc | |

Gjithashtu në këtë mbledhje KPM ka miratuar këto vendime në 3 raste të licencimit:

1. Radio Maria – Kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit;
2. Klan Kosova – Kërkesë për ndryshimin e skemës programore;
3. News TV – Kërkesë për ndryshimin e pronësisë;

KPM ka mbajtur mbledhjen e dhjetë me radhë për këtë vit me 22 shtator 2017. Në këtë mbledhje Komisioni ka shqyrtuar një ankesë të subjektit politik LDK kundër ofruesit të shërbimit medial audiovizual Klan Kosova. Pas shqyrtimit Komisioni ka ardhur në përfundim se nuk ka pas shkelje të legjislacionit të KPM dhe ankesa është hedhur poshtë si e pabazuar. Gjithashtu në këtë mbledhje janë marrë këto vendime për miratimin e kërkesave në 5 raste të licencimit:

1. OSHMA Suite TV – Kërkesë për licencë të re;
2. OSHMA Travelista – Kërkesë për licencë të re;
3. OSHMA Klan Kosova – Kërkesë për ndryshim të skemës programore;
4. OSHMA Zico TV – Kërkesë për ndryshim të skemës programore;
5. MAX TV – Kërkesë për ndryshim të certifikatës së biznesit nga NSh në SHPK.

Mbledhjen e njëmbëdhjetë për këtë vit KPM e ka mbajtur më 1 nëntor 2017. Fillimisht është shqyrtuar dhe pastaj është miratuar Raporti i Monitorimit të Mediave gjatë fushatës së Zgjedhjeve Lokale për

periudhën nga 21 shtator 2017 deri më 22 tetor 2017. Lidhur me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i shërbimeve mediale audiovizuale, KPM ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kanë të bëjnë me shkelje të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, shkelje të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, për zbatimin e të cilit është përgjegjës KPM, si dhe shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale KPM-2016/03.

Për shkelje të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, janë gjetur në shkelje këto shërbime mediale audiovizuale:

1. TV MIR - është sanksionuar me gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
2. TRIBUNA CHANNEL - është sanksionuar me gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
3. RTK 1 - është sanksionuar me gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
4. TV OPINION - është sanksionuar me gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
5. TV MOST - është sanksionuar me gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
6. TV DUKAGJINI është sanksionuar me gjobë në vlerë prej 2000 € (dy mijë euro).
7. KLAN KOSOVA është sanksionuar me gjobë, në lartësi prej 5000 € (pesë mijë euro) për shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale KPM-2016/03 si dhe Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073.

Ndërsa për shkelje të Nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM gjatë fushatës së zgjedhjeve, KPM ka marrë vendime me masën sanksionuese *Vërejtje* dhe sanksione me gjobë për këto raste:

1. TV FESTINA, dhe
2. RADIO VICTORY.

KPM në këtë mbledhje ka trajtuar edhe tetë raste të licencimit. KPM ka miratuar kërkesën për licencim 6 shërbimeve mediale audiovizuale përmes operatorit të shpërndarjes: Balkan Hot, Balkan Hot 2, Non Stop Shop – Direktno Kupujem, Tv Tajna, Tele Bet dhe TV Graçanica.

Gjithashtu, KPM ka marrë vendim për miratimin e kërkesave për ndryshim të emrit nga Travelista në Travelingo dhe kërkesa e OK Orange Net për ndryshim të formatit të biznesit nga N.T. në L.L.C.

KPM ka mbajtur mbledhjen e dymbëdhjetë me radhë për këtë vit më 22 nëntor 2017. Në këtë mbledhje KPM ka shqyrtuar dy raste ligjore, që kanë të bëjnë me shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale KPM-2016/03 dhe shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Shqyrtimi i ankesës së palës z. Gani Bajraktari ndaj RTK1 lidhur me mosdhënien e të drejtës së demantit për palën ankuuese. Pas shqyrtimit të ankesës, KPM erdhi në përfundim se RTK ka kryer shkelje të Kodit të Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale KKPM-2016/03, respektivisht Nenit 6 dhe Nenit 10. KPM vendosi që RTK1 në afat prej 7 ditësh të transmetojë reagimin e z. Bajraktari, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03. Gjithashtu në lidhje me këtë shkelje KPM vendosi që në bazë të nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, RTK 1, të sanksionohet me *Vërejtje*, për shkelje të nenit 6, paragrafi 2, dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Shqyrtimi i rastit të shkeljes nga TV Zoom për mossjellje të arkivës. Pas shqyrtimit të këtij rasti KPM ka gjetur se TV Zoom ka kryer shkelje të nenit 5, paragrafi 2, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, respektivisht mossjellje të arkivës. KPM vendosi që në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së, TV Zoom të sanksionohet me gjobë në vlerën prej 1.000 (njëmijë) euro për shkelje nenit 5, paragrafi 2, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

KPM në këtë mbledhje ka trajtuar edhe tri raste të licencimit dhe ka marrë këto vendime:

1. Miratim të kërkesës për ndryshim të pronësisë për operatorin e shpërndarjes Art Motion;
2. Miratim të kërkesës për ndryshim të pronësisë së Ofruesit të Shërbimit Medial Audiovizual Zico TV; dhe
3. Miratim të kërkesës për ndryshim të lokacionit të transmetuesit për Radio Maria.

Në mbledhjen e trembëdhjetë me radhë të mbajtur më 29 nëntor 2017, Komisioni ka miratuar Raportin e Monitorimit të Mediave gjatë fushatës së raundit të dytë të zgjedhjeve lokale, respektivisht balotazhit për kryetar të komunave në ato komuna ku ka pasur garë zgjedhore. Monitorimi ka zgjatur 7 ditë, pra fushata zgjedhore dhe heshtja zgjedhore, prej 13 deri më 19 nëntor 2017. Sa i përket shkeljeve që KPM ka identifikuar në monitorimin e shërbimeve mediale audiovizuale, janë iniciuar disa raste ligjore të cilat kanë të bëjnë me shkelje të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073.

Pas shqyrtimit të rasteve Komisioni erdhi në përfundim se janë gjetur në shkelje të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073 dhe sanksionohen këto shërbime mediale audiovizuale:

1. TRIBUNA CHANNEL - sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
2. TV MOST - sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
3. TV PULS - sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
4. TV MIR - sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),

5. TV DUKAGJINI - sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro),
6. RTK 1 - sanksionohet me masën gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro).
7. TV PRIZRENI - gjithashtu për shkelje të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, sanksionohet me masën Vërejtje, për shkak se është hera e parë që është gjetur në shkelje nga monitorimi i zgjedhjeve.

Mbledhjen e katërbëdhjetë dhe të fundit për vitin 2017, KPM e ka mbajtur më 21 dhjetor 2017. KPM ka miratuar amandamentimin (ndryshimin e neneve 11) e dy Rregulloreve:

- Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë – e amandamentuar
- Rregullore për Komunikimet Komerciale Audiovzuale – e amandamentuar

Në këtë mbledhje Komisioni ka miratuar tekstin e Strategjisë për Kalim në Transmetim Digjital të harmonizuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë e Përgatitjes dhe Miratimit të Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatimin e Tyre.

Gjithashtu Komisioni ka shqyrtuar edhe Raportin e monitorimit të mediave gjatë fushatës për procesin e rivotimit në komunën e Istogut. Lidhur me shkeljet e identifikuar gjatë procesit të fushatës zgjedhore, KPM ka shqyrtuar disa raste ligjore për mossjellje të ditareve A dhe B gjatë fushatës për Zgjedhjet e Përgjithshme, Zgjedhjet Lokale dhe Balotazh gjatë vitit 2017, ku mediat që janë gjetur në shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është marrë vendim sanksionues me Vërejtje.

Në këtë mbledhje KPM miratoi kërkesën e Operatorit të Shpërndarjes High Speed SHPK për ndërprerje të licencës.

HARMONIZIMI I TEKSTIT TË STRATEGJISË PËR KALIM NË TRANSMETIM DIGJITAL ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV Nr. 02/2012

Në lidhje me vazhdimin e punës në digjitalizimin e transmetimit tokësor, në mbledhjen e katërbëdhjetë të KPM e mbajtur më 21 dhjetor, Komisioni ka shqyrtuar tekstin e Strategjisë për Kalim në Transmetim Digjital, të harmonizuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë e Përgatitjes dhe Miratimit të Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatimin e Tyre.

Pas shqyrtimit Komisioni e ka miratuar dokumentin me ndryshimet e harmonizuara dhe më 22 dhjetor 2017, KPM e ka dërguar për aprovim në Qeveri.

Duhet përmendur edhe një herë se KPM ka përgatitur Strategjinë për Kalim në Transmetim Digjital në vitin 2015 dhe e ka dërguar për miratim në Qeveri. Strategjia është përfunduar pas një procesi gjithëpërfshirës konsultativ dhe në bashkëpunim me institucionet relevante të Kosovës, ato ndërkombëtare dhe me përfaqësues të industrisë mediale. Harmonizimi i Strategjisë së KPM-së me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2002 është kërkuar nga Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit si parakusht për miratim nga Qeveria. KPM tani është në pritje që Qeveria ta miratojë Strategjinë për Kalim në Transmetim Digjital, në mënyrë që të fillojë me implementimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit.

HARTIMI DHE AMANDAMENTIMI I AKTEVE NËNLIGJORE

Në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore që dalin nga Ligji për KPM-në Nr. 04/L-44 dhe Ligji Nr. 05/l-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore, KPM ka miratuar pesë (5) akte nënligjor duke respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore për krijimin e legjislacionit sekondar. Pas përfundimit të procedurave të parapara me ligj për nxjerrjen e legjislacionit sekondar (neni 8 i Ligjit për Nr. 04/L-44 KPM-në), duke ua vënë kështu në dispozicion përfaqësuesve të shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesit për të ofruar komente me shkrim, më 19 janar 2017, KPM ka miratuar këto akte nënligjore:

- Rregullore për Renditjen Logjike të Kanaleve;
- Rregullore për Bartjen e Detyrueshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale në Operatorin e Multipleksit;
- Rregullore për Operatorin e Multipleksit në Nivel Shtetëror;
- Rregullore për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale; dhe
- Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë

Ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2017, KPM ka miratuar/ amandamentuar këto akte nënligjore:

- Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë – e amandamentuar
- Rregullore për Komunikimet Komerciale Audiovizuale – e amandamentuar.

Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së

Bazuar në nenin 8 paragrafi 2, të Ligjit për KPM-në Nr. 04/L-44 dhe me qëllim të vënies në dispozicion të publikut dhe palëve të interesuara, KPM ka bën ftesë publike përfaqësuesve të shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesuara për të ofruar komente me shkrim këto dy draft rregullore:

- Draft Rregulloren për Tarifën për Licencë
- Draft Rregulloren për Komunikime Komerciale Audiovizuale

Draftet e këtyre rregulloreve janë vënë për konsultim publik prej 22 nëntor 2017 deri më 13 dhjetor 2017, ku palët e interesit kanë pas mundësinë të dërgojnë komentet e tyre. KPM i ka shqyrtuar të gjitha komentet dhe ato që kanë qenë të argumentuara në bazë ligjore, i ka vendosur në draft rregullore, dhe pastaj ka vazhduar me procesin e miratimit të akteve nënligjore.

RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT

Në kuadër të takimit të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) për “Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqëri Informativë” KPM ka marrë pjesë në dy takime të mbajtur më 26 janar 2017 dhe 30 nëntor 2017 në Prishtinë. Në këto takime përfaqësuesit e KPM-së kanë raportuar për zhvillimet institucionale, ecurinë e punës dhe vështirësitë e ndryshme që KPM po përballet në lidhje me plotësimin e kriterëve të BE-së siç janë: përfundimi i procesit të dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radio difuzive, harmonizimi i akteve nënligjore të KPM-së me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMS), si dhe zbatimin e akteve të reja nënligjore të miratura nga KPM e që dalin si obligim nga Ligji për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore.

KPM ka raportuar edhe lidhur me problemet tjera me të cilat po ballafaqohet institucioni për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, ku në kuadër të të gjitha detyrave dhe veprimeve të lartcekura, buxheti i KPM-së është zero si tek hartimi dhe amandamentimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian ashtu edhe tek procesi i dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radiodifuzive.

ORGANIZIMI I TAKIMEVE REGJIONALE ME MEDIA

Pas shkeljeve të identifikuar gjatë monitorimeve për pajtueshmërinë me rregulloret e KPM-së, veçmas pas shkeljeve të gjetura gjatë fushatës për Zgjedhjet e Përgjithshme, KPM ka organizuar takime me OSHMA-të në 6 regjione të Republikës së Kosovës. Kjo, me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë dhe profesionalizmit nga ana e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale.

Komisioni i Pavarur i Mediave ka organizuar prej 6 deri me 19 shtator 2017, një raund të tryezave regjionale në 6 regjione të Kosovës: Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Prishtinë.

Temat e diskutuara nga ana e KPM kishin për fokus kryesor punën e mediave gjatë fushatave zgjedhore, respektivisht lidhur me shkeljet e mediave dhe problemet tjera gjatë fushatës së fundit zgjedhore. Përveç pjesës së legjislacionit të KPM, është edhe zbatim i Kreut VIII i Ligjit Nr. 03/L-073, Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku KPM është e obliguar në monitorimin i mediave gjatë fushatave zgjedhore.

Në këto takime KPM ka prezantuar para Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) një përmbledhje të përgjithshme lidhur me zhvillimet në rregullativën ligjore të KPM-së, përfshirë edhe miratimin e rregulloreve të reja të KPM-së në lidhje me dixhitalizimin. Me fokus të veçantë të respektimit të legjislacionit të KPM nga ana e medive, respektivisht duke theksuar shkeljet e caktuara të rregulloreve të cilat më së shpeshti bëhen nga Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale.

Nga monitorimet e KPM ka rezultuar se problemet ose shkeljet me të shpeshta janë tek Kodi i Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, Rregullorja për të Drejtën e Autorit, Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë si dhe Kreu VIII i Ligjit për Zgjedhjet – pjesa që e obligon KPM, janë aktet nënligjore në të cilat mediat më së shumti kanë probleme me zbatimin e tyre. Në prezantimin e KPM lidhur me performancën e subjekteve transmetuese, u paraqiten shkeljet e gjetura nga monitorimi i mediave e në veçanti gjatë mbulimit të zgjedhjeve nacionale 2017, sipas Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Diskutimi dhe trajtimi i përbashkët i shkeljeve të gjetura ka rezultuar me më pak shkelje gjatë monitorimeve të radhës, veçmas të atyre gjatë fushatës për Zgjedhjet Lokale.

Këto takime rezultuan me vlerësimin se përderisa OSHMA-të duhet të jenë edhe më të përgjegjshme ndaj publikut të cilit ia ofrojnë misionin e tyre të informimit duke u siguruar që janë duke operuar në mënyrë profesionale dhe në suaza të përcaktimeve ligjore, edhe KPM mbetet e përkushtuar në gatishmërinë për të qenë në dispozicion të OSHMA-ve në ofrimin e këshillave dhe asistencës së nevojshme për OSHMA-të, në vështirësitë e tyre gjatë punës dhe problemet, të cilat ata i hasin gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre, sidomos gjatë fazës së fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale

MONITORIM I MEDIAVE GJATË ZGJEDHJEVE NACIONALE DHE ZGJEDHJEVE LOKALE 2017

Viti 2017 u karakterizua me mbajtjen e zgjedhjeve nacionale dhe lokale të cilat Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet nga të licencuarit. Kreu VIII i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat Gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM para fillimit të fushatës përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin, i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet, i cili përbëhet prej:

1. KAPITULLIT I – identifikimi i reklamimit politik;
2. KAPITULLIT II – raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
3. KAPITULLIT III – periudha e heshtjes zgjedhore.

Monitorimi gjatë fushatës për zgjedhjet nacionale 2017

Në përmbushje të këtij obligimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Ligjin për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së, nga të licencuarit, prej 31 maj deri më 11 qershor 2017, KPM ka monitoruar performancën e 23 ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA)-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore. Në fokus të këtyre monitorimeve ishin edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, spotet politike, intervistat e debatet në kohën e shikueshmërisë më të madhe, nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Gjatë monitorimit janë vlerësuar: paanshmëria në raportim, hapësira e ofruar për SCP-të, gjuha e përdorur si dhe pajtueshmëria me obligimet që dalin nga Kreu VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.)

Gjetjet kryesore të monitorimit të medieve nga KPM kanë qenë: publikimi i sondazheve/hulumtimit të opinionit, prezenca e fëmijëve në spote politike, transmetimi i spoteve politike të paidentifikuara, shkelja e heshtjes zgjedhore, shkelja e Kodit të Etikës – përdorimi i gjuhës së urrejtjes e denigruese dhe gjuha kundër integritet territorial i transmetuar nga disa televizione. Gjatë kësaj periudhe KPM e ka pranuar edhe një ankesë të PZAP e parashtruar nga një subjekt politik kundër një televizioni. Për të gjitha rastet e shkeljeve janë ndjekur procedurat e parapara të cilat kanë rezultuar me vendime sanksionuese nga ana e Komisionit.

Monitorimi gjatë fushatës për zgjedhjet lokale 2017 (raundi i parë dhe i dytë)

Në kuadër të obligimeve ligjore të KPM, respektivisht zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni i Pavarur i Mediave ka bërë edhe monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) të cilat kanë mbuluar fushatën e Zgjedhjeve Lokale 2017. Monitorimi ka pasur për qëllim vlerësimin e performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII “Mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve” të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Monitorimi i mediave gjatë raundit të parë ka përfshi periudhën nga 21 shtator deri më 22 tetor 2017. Në monitorim janë përfshirë 25 OSHMA, prej të cilëve nëntëmbëdhjetë (19) ishin me mbulim nacional, regjional dhe lokal në transmetim tokësor dhe gjashtë (6) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes.

Gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve në periudhën prej 13 nëntor 2017 deri më 19 nëntor 2017 janë monitoruar 24 OSHMA.

Monitorimi gjatë dy raundeve të zgjedhjeve lokale është bërë për programet e transmetuara nga ora 16:00 deri më 24:00.

Gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës).

Gjetjet kryesore të shkeljeve ligjore të evidentuara gjatë të monitorimit të medieve nga KPM kanë qenë: spotet politike më të gjata se dy minuta, spotet politike të paidentifikuara, prezencë e fëmijëve në spotet politike, dështim për të ofruar qasje të drejtë dhe të paanshme; shkelje e heshtjes zgjedhore dhe mos ofrim i Ditarëve A dhe B. Për të gjitha rastet e shkeljeve janë ndjekur procedurat e parapara të cilat kanë rezultuar me vendime sanksionuese nga ana e Komisionit.

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi me Misionin Vëzhgues nga Bashkimi Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve

Në kuadër të organizimit të punës lidhur me monitorimin e fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të përgjithshme me 11 qershor 2017, KPM ka vijuar bashkëpunimin me institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare. Në këtë kuadër KPM ka pas një bashkëpunim të ngushtë me Misionin Vëzhgues nga Bashkimi Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme me 11 qershor 2017. Fillimisht KPM ka mbajtur takime me delegacionin e vëzhguesve të këtij misioni para fillimit të fushatës. KPM i ka njoftuar përfaqësuesit e misionit vëzhgues lidhur me legjislacionin në fuqi dhe obligimet e përgjegjësitë e medieve sa i përket fushatës zgjedhore. Ndërsa gjatë fushatës dhe procesit të zgjedhjeve por edhe me pas, KPM ka vazhduar me këtë bashkëpunim duke iu ofruar të dhënat e kërkuara nga ky mision lidhur me gjetjet e KPM gjatë monitorimit të medieve në fushatën zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

Bashkëpunimi në kuadër të platformës evropiane të autoriteteve rregullatore (EPRA)

Në kuadër të platformës EPRA, anëtare e të cilës është KPM nga viti 2003, mundësohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me autoritetet evropiane rregullatore për politikën audiovizuale. Ky bashkëpunim realizohet përmes takimeve të rregullta vjetore që bëhen dy herë brenda vitit. Në 2017 është mbajtur takimi i 45-të me radhë në maj në Edinburg kurse në tetor takimi i 46-të me radhë në Vjenë. Natyra e takimeve të EPRA-së është e karakterit të trajtimit të çështjeve në fushën e rregullimit të shërbimeve mediale audiovizuale, prezantimit të trendeve më të reja në rregullimin e transmetimit në nivel evropian si dhe e ofrimit të alternativave për zgjidhjen e këtyre sfidave bazuar në përvojat e ndryshme. KPM-së në këto takime përfaqësohet me zyrtërë përgjegjës të fushës, varësisht nga temat e agjendës së përcaktuar për trajtim në Konferencën respektive. Fokusi i këtyre takimeve ka qenë në prezantimin e lajmeve në epokën digjitale, edukimin medial, procedurat e licencimit dhe të autorizimeve të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale, të ardhmen e radios dhe është diskutuar

edhe për marrëdhënien në mes të qytetarëve dhe rregullatorëve. Zhvillimet e hovshme që janë duke përcjellur sektorin audiovizual viteve të fundit kanë sjellë nevojën që të ketë interaktivitet edhe mes publikut dhe rregullatorëve në mënyrë që publiku të edukohet e përgatitet për të pranuar drejtë atë çka ofron media.

Bashkëpunimi në kuadër të rrjetit mediteran të autoriteteve rregullatore (MNRA)

KPM është anëtare edhe e MNRA-së, e cila poashtu ofron mundësinë e marrjes së përkrahjes profesionale nga autoritetet tjera rregullatore për çështje me të cilat ballafaqohet KPM gjatë hartimit të legjislacionit sekondar por edhe në trajtim të çështjeve në baza ditore. MNRA ka organizim të atillë që mban takime të rregullta vjetore në të cilat trajtohen çështje që kanë të bëjnë me rregullimin e transmetimit mirëpo me fokus më të veçantë në përfaqësimin konkret të grupeve të caktuara në media. Në mbledhjen e nëntorit 2017, në Marsejë, janë trajtuar problematikat që kanë të bëjnë me trajtimin e fenomenit të migrimit nga ana e mediave, përfaqësimin gjinor, mediat dhe sigurinë dhe poashtu edhe edukimin medial dhe mbrojtjen e fëmijëve. Në takimin e MNRA-së është diskutuar edhe rishikimi i Direktivës për Shërbimet Mediale Audiovizuale. KPM është e obliguar që legjislacionin sekondar ta harmonizojë me këtë Direktivë dhe falë mundësisë që ofrohet në kuadër të anëtarësimit si të MNRA-së ashtu edhe të EPRA-s informimi dhe parapërgatitja për të reja që do të pasojnë në nivel evropian kanë dëshmuar të jenë ndihmesë e madhe për proceset e amandamentimeve dhe rishikimeve të rregulloreve përkatëse të KPM-së.

PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefja Ekzekutive, e cila e ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, Kryeshefja Ekzekutive menaxhon:

- me nëpunësit civilë të KPM-së;
- me financat dhe me burimet tjera të financimit;
- ofron këshilla për politikat e KPM-së;
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive si dhe;
- bën koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë 4 departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Departamenti i Administratës (*Shtojca 1 Organogrami*):

1. Departamenti i Monitorimit dhe Analizës;
2. Departamenti i Licencimit,
3. Departamenti Ligjor
4. Departamenti për Menaxhim Frekuencor
5. Departamenti i Administratës.

Burimet njerëzore

Personeli i Zyrës Ekzekutive janë shërbyes civilë dhe janë të miratuara gjithsej 31 pozita deri në vitin 2017. Ndërsa në fund të vitit 2017, Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike kanë miratuar kërkesat disavjeçare për ngritje të numrit të punonjësve prej vitit 2018 edhe me 6 pozita të reja.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore në Zyrën Ekzekutive, pritet të arrijë të rrisë edhe efikasitetin në punën dhe përgjegjësitë e KPM-së në kuadër zgjerimit të fushës së kompetencës dhe trendin në rritje të numrit të të licencuarve.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE (DMA)

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave (DMA), gjatë vitit 2017, ka vlerësuar pajtueshmërinë e të licencuarve me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe rregulloret e KPM-së, ndërsa gjatë fushatës për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale ka vlerësuar pajtueshmërinë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 në Republikën e Kosovës.

Rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra dhe realizimit të aktiviteteve të poshtëshënuara, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të Zyrës Ekzekutive të KPM-së kanë mbështetur veprimet e mëtutjeshme.

Monitorimi i Mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjeve të Përgjithshme dhe Lokale 2017 në Republikën e Kosovës

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duke qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i cili vlen edhe për zgjedhjet lokale, ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA) të cilat kanë mbuluar fushatën për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ato Lokale të mbajtura gjatë vitit 2017 në Republikën e Kosovës.

Fokus i këtyre monitorimeve ishin edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe pikat reklamuese politike në kohën e shikueshmërisë më të madhe, nga ora 16:00 deri 24:00, si dhe performanca e OSHMA-ve gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore. Gjatë monitorimit janë bërë matjet e hapësirës së dedikuar kandidatëve pjesëmarrës në këto zgjedhje si dhe është vlerësuar edhe mënyra e raportimit të OSHMA-ve gjatë fushatës.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, para fillimit të fushatave zgjedhore, KPM ka përcjell tek të gjithë të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve, i cili është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje.

KPM ka pranuar një (1) ankesë gjatë periudhës së Zgjedhjeve të Përgjithshme, ndërsa gjatë dy raundeve të Zgjedhjeve Lokale ka pranuar katër (4) ankesa nga Subjektet e Cerifikuara Politike, të cilat kanë pretenduar për shkelje të Ligjit për Zgjedhje nga OSHMA.

Monitorimi i gjatë fushatës së Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Nga data 31 maj deri më 11 qershor 2017, DMA-ja ka bërë vlerësimin e performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”³

³ Raport monitorimi i mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve të përgjithshme 2017 – Shtojca IVa

Në monitorim janë përfshirë njëzet e tre (23) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuale (OSHMA) me transmetim tokësor me mbulim nacional, regjional e lokal si dhe OSHMA-të me program gjeneralistik të cilët operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes.

Bazuar në këto monitorime, KPM ka gjetur se mbulimi i garës për Zgjedhjet e Përgjithshme 2017 ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII të këtij Ligji.

Monitorimi i Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës

Edhe gjatë organizimit të Zgjedhjeve Lokale 2017, DMA ka monitoruar OSHMA-të lidhur me pajtueshmërinë me Ligjin për Zgjedhje. Monitorimet nga data 21 shtator deri më 22 tetor 2017, janë bërë për raundin e parë të zgjedhjeve lokale⁴ ndërsa nga data 13 deri më 19 nëntor 2017 janë bërë për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale.⁵

Në raundin e parë të zgjedhjeve lokale në monitorim janë përfshirë njëzet e pesë (25) OSHMA, që u takojnë kategorive me mbulim nacional, regjional dhe lokal në transmetim tokësor si dhe OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes.

Ndërsa, gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve lokale në monitorim janë përfshirë njëzet e katër (24) OSHMA. Gara për balotazh është organizuar në nëntëmbëdhjetë (19) komuna të Republikës së Kosovës, ndërsa në një (1) komunë është zhvilluar rivotimi për raundin e parë.

Prezantimi i të dy raundeve të fushatës për zgjedhjet lokale nga OSHMA-të ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm.

Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së – Pjesa 3 e Licencës

Licenca e KPM-së përbënë një kontratë të detyrueshme për të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin për KPM-në, me kushtet dhe termet e saj si dhe me të gjitha Pjesët e tjera të Licencës së KPM-së.

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së OSHMA-ve TV DUKAGJINI dhe TV MITROVICA me Pjesën 3 të Licencës, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës ka realizuar monitorimin e programit të këtyre OSHMA-ve. Të gjeturat nga ky monitorim kanë mundësuar krijimin e një pasqyre më të saktë për pajtueshmërinë e tyre me skemën programore.

Gjatë këtij monitorimi është analizuar formati dhe struktura programore e programit një javor të ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale.

⁴ Raport monitorimi i mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale 2017 – raundi i – Shtojca IVb

⁵ Raport monitorimi i mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale 2017 - raundi II – Shtojca IVc

Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit

Rregullorja për të Drejtën e Autorit përcakton se të licencuarit duhet të sigurojnë marrëveshje të vlefshme për të drejtën e autorit, kopjet e të cilave duhet t'ia ofrojnë KPM-së brenda afatit të paraparë në kërkesë. Pas transmetimit të programeve të caktuara dhe me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë Rregullore, OSHMA-ve të monitoruara u janë kërkuar marrëveshjet valide për të drejtën e autorit për programet e transmetuara.

Gjatë vitit 2017, për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit janë realizuar gjithsejtë njëzet e gjashtë (26) monitorime të OSHMA-ve, prej të cilave shtatë (7) kanë rezultuar në shkelje. Në bazë të monitorimeve të bëra është gjetur se shkeljet kanë të bëjnë kryesisht me transmetimin e programeve pa të drejtën e autorit dhe mos-ofrimin e marrëveshjeve të kërkuara nga KPM.

Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2017/06 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale

Sasia e reklamave të transmetuara brenda një ore program, vendosja e produkteve, sponsorizimet, teleshoppingu, reklamimi me ekran të ndarë si dhe dispozita tjera, ishin fokus i monitorimeve për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

Lidhur me këtë rregullore janë realizuar tridhjetë e pesë (35) monitorime, prej të cilave njëmbëdhjetë (11) kanë rezultuar në shkelje të kësaj rregulloreje.

Gjatë këtyre monitorimeve janë identifikuar shkelje të neneve të cilat kishin të bëjnë me transmetimin e reklamimit televiziv gjatë programeve të lajmeve (në lajme me kohëzgjatje më të shkurtër se 30 minuta apo transmetim i disa blloqeve të reklamimit brenda një edicioni të lajmeve), mos dallimin e komunikimeve komerciale audio-vizuale nga pjesët tjera programore, tejkalim të kohëzgjatjes së reklamimit televiziv brenda një ore transmetimi, mos paralajmërim të vendosjes së produktit në programe, mos identifikimi i duhur i programeve të sponsorizuara, transmetim i dritareve të teleshoppingut më të shkurtër se 15 minuta si dhe sponsorizim të programeve të çështjeve aktuale.

Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, janë monitoruar OSHMA-të me mbulim nacional, regional e lokal si dhe OSHMA-të që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Lidhur me këtë rregullore janë realizuar tridhjetë e gjashtë (36) monitorime, gjashtëmbëdhjetë (16) prej të cilave kanë rezultuar me shkelje të kësaj rregulloreje nga ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale.

Shkeljet më të shpeshta të identifikuar gjatë monitorimit kishin të bëjnë me kufizimet dhe obligimet e përgjithshme të shërbimeve mediale audio-vizuale si: mos paralajmërimi me sinjal akustik apo tekstual

para fillimit dhe pas ndërprerjeve të programeve me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur, transmetimi i programeve të kategorive të caktuara jashtë kohës së paraparë sipas rregullores, mos përdorimi i simboleve përkatëse vizuale si dhe përdorimi i ngjyrave të shenjave/simboleve përkatëse ndryshe nga ato të përcaktuara në rregullore.

Është karakteristike të përmendet se shumica e shkeljeve janë bërë me rastin e reprizimit gjatë ditës, të programeve të kategorive të dytë, tretë dhe katërtë, veçmas të filmave artistik dhe serialeve. Nga monitorimet e bëra tash e sa vite, është vërejtur edhe tendenca e OSHMA-ve që t'i kategorizojnë përmbajtjet programore në kategori më të ulëta, në mënyrë që ato t'i transmetojnë në orët më të hershme të mbrëmjes.

Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Pajtueshmëria me Kodin Etikë për Ofruesit e Shërbimeve Mediale është vlerësuar kryesisht me rastin e ankesave nga publiku ose rasteve *ex officio* për shkelje të Kodit të Etikës, të iniciuara nga KPM. Gjatë vitit 2017, në KPM janë parashtruar gjithsej 13 ankesa të cilat kanë pretenduar për shkelje të Kodit të Etikës nga ana e OSHMA-ve.

Lidhur me ankesat e pranuar të cilat pretendojnë për shkelje gjatë transmetimit të përmbajtjeve të caktuara programore si dhe rastet e iniciuara *ex officio*, DMA ka bërë monitorime dhe analiza të detajuara. Gjetjet dhe rekomandimet pas shqyrtimit të ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera kanë vazhduar procedurat e mëtutjeshme.

Gjatë periudhës së zgjedhjeve të përgjithshme, KPM ka iniciuar raste lidhur me prezencën e fëmijëve në pikat reklamuese politike, të cilat përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës.

Në përgjithësi, shkeljet kishin të bëjnë me mos mbulimin të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënies politike dhe mos sigurim të një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, raportime jo të sakta të lajmeve dhe në mënyrë të anshme, sulme personale ndaj individëve, ndërhyrje në çështjet thjeshtë private apo personale të cilat nuk kanë ndikim në interesin publik, përdorimin dhe prezencën e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike, mos transmetimi i reagimit përkatës, mos ofrimi i të drejtës për reagim, mos respektimi i të drejtës së individit që të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia nga gjykata kompetente, mos ndërmarrja e veprimeve të duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga ana e pjesëmarrësve në program, dallimi jo i qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit dhe mos korigjimi i informacionit të publikuar që është gjetur të jetë i pasaktë.

Monitorimi i edicioneve qendrore të lajmeve

Për shkak të ndikimit që edicionet e lajmet kanë në formimin e perceptimeve dhe qëndrimeve tek publiku, DMA ka bërë monitorimin e edicioneve qendrore të lajmeve të transmetuara në OSHMA-të me program gjeneralistik: RTK1, KTV, TV21, Klan Kosova, Rrokum TV e Tribuna Channel.

Për realizimin e këtij projekti, nga data 09 deri më 15 janar 2017, janë monitoruar dhe analizuar edicionet qendrore të lajmeve të OSHMA-ve të lartpërmendura lidhur me mënyrën e raportimit, paanshmërinë, saktësinë dhe gjuhën e përdorur.

Gjithashtu, gjatë monitorimeve është vlerësuar nëse në këto edicionet të lajmeve ka pasur përmbajtje të dëmshme dhe fyese, shkelje të privatësisë, gjuhë vulgare dhe ofenduese, nxitje të urrejtjes, respektim të të drejtave individuale, balancim të storieve dhe dispozitave tjera të përcaktuara në Kodin e Etikës. Është analizuar edhe mënyra e paraqitjes apo përfshirjes së fëmijëve, nëse ka pasur skena të dhunës e frikës, si dhe diversitet e renditje të temave sipas rëndësisë.

Gjetjet nga ky monitorim flasin se informatat e dhëna në storie ishin kryesisht korrekte, ndërsa në shumicën e rasteve në program janë përdorur imazhe dhe gjuhë neutrale si dhe nuk është vërejtur të ketë pasur gjuhë apo imazhe nxitëse. Lajmet qendrore ishin kryesisht të përqendruara në raportimet rreth zhvillimeve politike në Kosovë, ndërsa personalitetet që dominuan me paraqitje vizuale dhe përmbajtësore në edicionet e monitoruara ishin në cilësinë e përfaqësuesve të subjekteve politike.

Mbase për shkak të ngjarjeve të javës së monitoruar, në edicionet e lajmeve kanë dominuar temat nga jeta politike e aty-këtu edhe ndonjë temë nga arsimi, shëndetësia e tema sociale. Përkundër agjendës së ngjeshur me ngjarje të rëndësishme politike të asaj jave, DMA konstaton se në këtë periudhë OSHMA-të është dashur të ofrojnë diversitet më të madh temash me interes për qytetarët.

Gjithashtu, është konstatim nga monitorimi se për një mbulim më të balancuar e më korrektë të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërtënieve politike, OSHMA-të duhet të sigurojnë paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, duke ofruar prezantim të këndvështrimit edhe të një pale të tretë.

Monitorimi për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së Operatorëve të Shpërndarjes

Miratimi i Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale ka determinuar edhe aktivitetin e DMA-së për monitorimin e të licencuarve. Gjatë vitit 2017, DMA ka realizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve karshi objektivave të saj, për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit të KPM-së nga ana e të licencuarve me status të operatorit të shpërndarjes (OSH).

Lidhur me pajtueshmërinë e operatorëve të shpërndarjes janë kryer njëzet e gjashtë (26) monitorime, prej tyre njëmbëdhjetë (11) në bazë të ankesave. Ankesat kishin të bëjnë me operime ilegale si dhe transmetime pa të drejtën e autorit të programeve/kanaleve të caktuara. DMA në bashkëpunim edhe me departamentet tjera ka realizuar monitorime në terren në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke verifikuar rastet e tilla, për të cilat janë ndërmarrë veprime konkrete varësisht nga natyra e rasteve.

Ndërsa, me qëllim të sigurimit të të dhënave të përditësuara në lidhje me të drejtat e ritransmetimit të operatorëve të shpërndarjes, por edhe të ofertës së tyre programore për qytetarët, në fillim të këtij viti është kërkuar nga operatorët e shpërndarjes të deponojnë në KPM katalogët e azhurnuar të kanaleve si dhe marrëveshjet e reja për të drejtat e ritransmetimit/përmbajtjeve programore. Lidhur me monitorimet e bëra, DMA ka përcjellë te Departamenti Ligjor për procedim të mëtutjeshëm të gjitha rastet lidhur me shkeljet e Ligjit, rregulloreve të KPM-së si dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së. Kështu që, gjatë vitit 2017 kanë operuar gjithsej 20 TV Stacione, 83 Radio Stacione, 39 Operator të Shpërndarjes (1 OTT dhe 4 IPTV) dhe 61 Ofrues të Shërbimeve Mediale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes.

Nga 20 shërbimet mediale televizive me transmetim tokësor të licencuara nga KPM-ja, tre (3) i përkasin kategorisë me mbulim nacional, dymbëdhjetë (12) me mbulim regional dhe pesë (5) me mbulim lokal. Kategorizimi është i bazuar në vendndodhjen e transmetuesve dhe parametrave teknik.

Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhës kryesore në të cilën transmetojnë:

Të licencuara 20 TV stacione:

- *1 TV stacion publik;*
- *13 TV stacione në gjuhën shqipe;*
- *5 TV stacione në gjuhën serbe;*
- *1 TV stacion në gjuhën turke.*

Të licencuara 83 Radio stacione:

- *2 radio stacione të transmetuesit publik;*
- *48 radio stacione në gjuhën shqipe;*
- *23 radio stacione në gjuhën serbe;*
- *3 radio stacione në gjuhën boshnjake;*
- *3 radio stacione në gjuhën turke;*
- *2 radio stacione në gjuhën gorane;*
- *1 radio stacion në gjuhën rome;*
- *1 radio stacion multi-etnike.*

Numri Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:

Të licencuar 39 operatorë të shpërndarjes

- 33 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë shqiptar;
- 2 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë boshnjak/goran;
- 4 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë serb.

Ofruesit e Shërbimeve Mediale Adio dhe Adiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes

Gjithsej janë të licencuar 61 Ofrues të Shërbimeve Mediale Adio dhe Adiovizuale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit të operatorëve të shpërndarjes.

- 50 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- 8 OSHMA është i licencuar të transmetojë program në gjuhën Serbe
- 3 OSHMA janë të licencuar që transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art).

Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2017, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 36 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHP-së, kërkesa për licencë të operatorëve të shpërndarjes, kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë, njoftime për heqje dorë nga licenca, ankesa për interferenca, refuzim ndaj kërkesave si të pa bazuara apo të pa kompletuara si dhe kërkesa që kanë të bëjnë me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së KPM-së.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2017 janë marrë këto vendime për licencim:

- 14 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilët transmetojnë përmes OSH;
- 3 vendime për licencimin e operatorëve të shpërndarjes;
- 8 vendime për ndryshimin e pronësisë (në dy raste me vendime për ndryshim të pronësisë janë ndryshuar edhe emrat e subjekteve sipas kërkesave);
- 5 vendim për ndryshimin e parametrave teknike të licencës;
- 2 vendim për ndërprerje të licencës;
- 3 vendime për ndryshimin e skemës programore; dhe

- 1 vendim për ndryshimin e emrit.

Rastet të cilat janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit, gjithsejtë janë 3:

- 2 raste lidhur me ndërhyrjet në frekuencat e transmetimit;
- 1 rast për mos transmetim sipas parametrave teknik.

Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2018, janë gjithsej 4 raste:

- 3 kërkesë për ndryshimin e pronësisë; dhe
- 1 kërkesë për zgjerim të mbulimit – frekuencë shtesë.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar raste të ndryshme të Ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (tutje OSHMA) dhe Operatorëve të shpërndarjes (tutje OSH) për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër OSHMA dhe OSH .

Rastet e proceduara në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit për KPM-në dhe akteve nënligjore të KPM-së⁶ janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit Vjetor

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka proceduar gjashtëdhjetekatër (64) raste për mos sjellje të raportit vjetor. Të gjithë të licencuarve të cilët kanë dështuar të veprojnë në pajtim me nenin 28 të Ligjit të KPM-së u janë dërguar njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Nëse këto subjekte dështojnë të dorëzojnë raportin vjetor në KPM edhe për vitin pasues atëherë Departamenti Ligjor do t'i rekomandojë komisionit shqiptimin e masave më të ashpra sanksionuese në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM -2013/03

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka proceduar njëmbëdhjetë (11) raste kundër OSHMA që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2013/03 Të gjitha këto subjekte kanë pranuar njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Nëse këto subjekte në të ardhmen dështojnë të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/03, atëherë Departamenti Ligjor do t'i rekomandojë komisionit shqiptimin e masave më të ashpra sanksionuese në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

⁶ Shih Shtojcën II “Paraqitja Tabelare e Rasteve Ligjore”

Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM- 2013/01

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka proceduar nëntë (9) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01. Të gjitha këto subjekte kanë pranuar njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Nëse këto subjekte në të ardhmen dështojnë të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/01, atëherë Departamenti Ligjor do t'i rekomandojë komisionit shqiptimin e masave më të ashpra sanksionuese në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka proceduar dhjetë (10) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

TV Dukagjini është proceduar për shkelje të të Pjesës së tretë të licencës , i cili pas Njoftimit për shkelje ka ardhur në pajtueshmëri.

KPM ka shqyrtuar ankesën e Radio Star ndaj Radio Rinia me pretendimin për interferencë dhe ka gjetur se Radio Rinia nuk është duke e transmetuar në frekuencën me të cilën është licencuar, duke shkaktuar interferenca në tërë brezin frekuencor. Në bazë të Rekomandimit të Departamentit Ligjor Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta sanksionojë me Vërejtje Radio Rinin. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.

Raste tjera të shkeljeve të Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës janë të OSHMA-ve TV Besa, TV Ballkani, TV Iliria dhe TV Festina për ndërprerjen e transmetimit në rrjetin tokësor. Në bazë të Rekomandimeve të Departamentit Ligjor, Komisioni i KPM-së mori Vendime që këto OSHMA të sanksionohen me Vërejtje. Pas Vendimit, TV Iliria dhe TV Festina kanë filluar transmetimin tokësor, ndërsa TV Besa dhe TV Ballkani barten për vitin 2018.

Rast tjetër i shkeljes së Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës është ndërprerja e transmetimit nga TV Herc, i cili pas Njoftimit për shkelje nga ana e Departamentit Ligjor ka filluar transmetimin. Rasti është mbyllur.

Raste tjera të shkeljes së Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës janë edhe mosjellja e arkivës nga TV Tema, TV Zoom dhe TV Kiss. KPM iu ka dërguar Njoftim për shkelje të gjitha këtyre OSHMA-ve ku TV Tema dhe TV Kiss kanë ardhur në pajtueshmëri. Ndërsa, TV Zoom ka dështuar ta sjellë arkivin dhe në bazë të Rekomandimit të Departamentit Ligjor, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta sanksionojë TV Zoom-in me gjobë në vlerën prej 1.000 euro. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2014/03 - Mos pagesa e taksës për licencë

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 i ka dërguar në përmbarrim gjashtëdhjetetë (63) ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale të cilat nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2016.

Rastet për shkeljen e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka proceduar trembëdhjetë (13) raste të shkeljeve dhe ankesave të Operatorëve të Shpërndarjes (OSH).

Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftime për Shkelje të gjithë këtyre OSH. Pas Njoftimeve për shkelje disa nga OSH kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur. Ndërsa për OSH të cilët kanë vazhduar të veprojnë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2016/01 në bazë të Rekomandimeve të Departamentit Ligjor, Komisioni i KPM-së mori Vendime që t'i dënojë Artmotion dhe Telekomin e Kosovës me Vërejtje. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores për të Drejtën e autorit KPM 2013/02

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka proceduar tetë (8) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen e Rregullores për të Drejtën e autorit KPM 2013.

Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftimeve për Shkelje të gjitha këtyre OSHMA-ve për shkelje të Rregullores KPM-2013/01. Të gjitha këto subjekte do të monitorohen serish për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2013. Rastet janë mbyllur.

Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 48, nenit 49, paragrafit 6 dhe 7, nenit 52, paragrafit 1, si dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, nenit 9 paragrafit 7

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2017 ka proceduar tetëdhjetepesë (85) raste lidhur me shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet t e lartpërmendura në tri palë zgjedhje: Zgjedhjet e Përgjithshme, Zgjedhjet Lokale dhe Zgjedhjet e Balotazhit.

Për të gjitha këto shkelje të OSHMA-ve Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftime për shkelje. Rastet të cilat kanë ardhur në pajtueshmëri janë mbyllur. Ndërsa për rastet të cilat kanë vazhduar të jenë në shkelje Departamenti Ligjor i ka rekomanduar Komisionit të KPM-së ndërmarrjen e masave sanksionuese.

Komisioni pas rekomandimeve të Departamentit Ligjor për shkeljet gjatë fushatës së Zgjedhjeve të Përgjithshme me masën sanksionuese *Vërejtje* ka dënuar këto OSHMA:

- | | |
|--------------------|--------------------|
| 1. RTV 21 | 8. TV Herc |
| 1. TV Opinion | 9. TV Most |
| 2. TV Mir | 10. TV Puls |
| 3. TV Kim | 11. TV Syri Vision |
| 4. Rrokum TV | 12. RTK 1 |
| 5. Tribuna Channel | 13. TV Iliria |
| 6. TV Besa | 14. TV Vali |
| 7. TV Dukagjini | 15. Klan Kosova |

Për shkelje gjatë fushatës së Zgjedhjeve Lokale me masën sanksionuese dënim me gjobë dhe Vërejtje janë dënuar këto OSHMA:

- | | |
|----------------------------|--------------------------------|
| 1. Klan Kosova, 5.000 euro | 6. TV Dukagjini, 2.000 euro |
| 2. RTK 1, 1.000 euro | 7. Tribuna Channel, 1.000 euro |
| 3. TV Mir, 1.000 euro | 8. TV Festina, Vërejtje |
| 4. TV Most, 1.000 euro | 9. Radio Victoria, Vërejtje |
| 5. TV Opinion, 1.000 euro | |

Ndërsa për shkelje gjatë fushatës së Zgjedhjeve të Balotazhit me masën sanksionuese dënim me gjobë dhe Vërejtje janë dënuar këto OSHMA:

- | | |
|------------------------|--------------------------------|
| 1. TV Mir, 1.000 euro | 5. Tribuna Channel, 1.000 euro |
| 2. TV Most, 1.000 euro | 6. TV Dukagjini, 1.000 euro |
| 3. TV Puls, 1.000 euro | 7. TV Prizreni, Vërejtje |
| 4. RTK 1, 1.000 euro | |

Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03

Janë proceduar dhjetë (10) raste:

1. Rasti i parë është proceduar bazuar në ankesën e z. Milaim Zeka ndaj OSHMA Tribuna Channel, Ankesa i referohet emisionit Republika ku ishte i ftuar Ramiz Lladrovci, me pretendimin se gjatë emisionit atij i është shkaktuar dëm i pariparueshëm pasi që mysafiri e ka fyer dhe shpifur për të. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se Tribuna Channel ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje Tribuna Channel. Më pas palët janë marrë veshë mes vete dhe rasti është mbyllur.
2. Rasti i dytë është proceduar bazuar në ankesën e z. Vuk Mitrovic ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet emisionit Udhëve, me pretendimin se gjatë emisionit atij i është keqpërdorur emri, mbiemri dhe fotografitë personale, duke e ndërlidhur me aktivitete terroriste. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se RTK 1 nuk ka bërë

shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar shkresë z. Vuk Mitrovic. Rasti është mbyllur.

3. Rasti i tretë është proceduar bazuar në ankesën e Shoqatës së Gazetarëve të Sërbisë ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet emisionit Monitor, me pretendimin se gjatë emisionit janë identifikuar emrat e disa personave serbë sikur janë spiunë rusë dhe kjo mund të kontribuojë në rritjen e tensioneve ndëretnike. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje RTK 1. Rasti është mbyllur.
4. Rasti i katërt është proceduar bazuar në ankesën e znj. Blerina Lubishtani ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit Zyra e ankesave, me pretendimin se gjatë dy ditëve ajo është përgojuar dhe ofenduar. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV Dukagjinit. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë TV Dukagjinin me Vërejtje. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.
5. Rasti i pestë është proceduar bazuar në ankesën e Index Kosova ndaj OSHMA Rrokum TV. Ankesa i referohet emisionit Rrokum Roll, me pretendimin se të ftuarit kanë shpifur dhe fyer drejtuesit e kompanisë private hulumtuese dhe sondazheve Index Kosova. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se Rrokum TV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje Rrokum TV. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë Rrokum TV me Vërejtje. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.
6. Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në ankesën e znj. Adelina Reçica-Asanaj ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit Zona Express “Njëmbëdhjetë thikat”, me pretendimin se gjatë dy pjesëve të këtij emisioni janë përhapur të dhëna të pavërteta të cilat janë fyese. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV Dukagjinit. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë TV Dukagjinin me gjobë në vlerë prej 2.000 euro. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.
7. Rasti i shtatë është proceduar bazuar në ankesën e Devolli Group ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit Zona Express “Devollistan”, me pretendimin se gjatë këtij emisioni janë bërë fyerje, sulme personale dhe njolloasje e dinjitetit personal. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë

shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV Dukagjinit. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë TV Dukagjinin me gjobë në vlerë prej 2.000 euro. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.

8. Rasti i tetë është proceduar bazuar në ankesën e OSHMA Tribuna Channel ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ndërkohë Palët janë marrë veshë dhe rasti është mbyllur.
9. Rasti i nëntë është proceduar bazuar në ankesën e z. Frashër Oseku ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet lajmeve qendrore, me pretendimin se në kronikën e transmetuar është shpifur gjoja se ka qenë anëtar i Lëvizjes VV. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se RTK 1 nuk i ka dhënë të drejtën e reagimit Palës Ankuese, duke bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje RTK 1, në të cilin i është kërkuar që t'ia japë të drejtën e reagimit. Rasti është mbyllur.
10. Rasti i dhjetë është proceduar bazuar në ankesën e z. Gani Bajraktari ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet lajmeve qendrore, me pretendimin se në kronikën e transmetuar janë lansuar të pavërteta në lidhje me saktësinë e diplomave të specializimeve të Palës Ankuese. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se RTK 1 nuk i ka dhënë të drejtën e reagimit Palës Ankuese, duke bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje RTK 1. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë RTK 1 me Vërejtje. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge

Gjatë vitit 2017, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre. Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2016, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (65 dBuV/m për TV dhe dhe e painterferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimi i rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Gjatë vitit 2017 Departamentit për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2017, të cilat kanë patur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 Mhz).

DMF- ja gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njejtë si dhe gjatë vitit paraprak që tregonë se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa, niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dbuv/m. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivove, Llabjan, Parllövë dhe Bresalc); Kacanik – Hani i Elezit; Mitrovicë – Bajgorë; Shtime – Carralevë, Dragash – Restelicë; Prizren – Brezovicë; Kramovik – Dollc; Pejë – Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka fare pranim të sinjalit të radiove nacionale.

Në bazë të këtyre rezultateve, KPM konstaton se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, dhe Radio 21 nuk janë duke transmetuar në pajtim me parametrat teknikë siç janë të përcaktuara me pjesën 2 të licencës së KPM-së, nërsa Radio Dukagjini në koordinim me KPM-në është duke bërë zgjerimin e zonës së mbulimit në tërë territorin e Kosovës.

Me gjithë rekomandimin e bërë nga ana e KPM-së, radiove nacionale, që të transmetojnë në pajtim të plotë me parametrat teknikë të përcaktuara në pjesën 2 të licencës së KPM-së me qëllim të ngritjes së cilësisë së sinjalit të transmetimit si dhe shërbimin më cilësor në zonat e përcaktuara me licencë të KPM-së, radiot nacionale nuk janë përgjigjur fare me përjashtim të Radio Dukagjinit, në lidhje me veprimet që kanë ndërmarrë. KPM është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa, në bashkëpunim me ta edhe të gjejmë lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e painederuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës. Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth **68.14%** të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës.

Rastet për interferenca

Gjatë vitit 2017 DMF, ka pranuar pesë ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese radio Radio Star (Gjilan), Radio Glam (Prishtinë), Radio Dukagjini (Pejë) Radio Plus (Prishtinë) dhe Top Iliria Radio. Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Star sipas të cilës është i interferuar nga radio Gjilani dhe nga Radio Rinia.

Pas matjeve në terren, është konstautuar se Radio Gjilani dhe Radio Rinia kanë probleme me sistemin e transmetimit ku si rezultat shkaktojn interferenca në brezin FM. Pas rekomandimeve të KPM-së për (Radio Gjilan dhe Radio Star) rregullimin e këtij problemi, interferencat e paraqitura janë eliminuar.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Glam sipas së cilës është i interferuar nga Radio Prishtina. Pas matjeve në terren është konstatuar se problemi me interferenc nuk ekziston dhe se radio Glam është e pa interferuar.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Dukagjinit sipas së cilës është i interferuar në regjionin e Mitrovicës. Pas matjeve në terren është konstatuar se frekuenca e Radio Dukagjinit është e interferuar gabimisht nga një transmetues nga pika e Cernushës. Pas kërkesës ton problemi me interferencë është eliminuar po atë ditë.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Plus sipas së cilës është i interferuar nga Radio Kosova e lirë. Pas matjeve në terren është konstatuar se frekuenca e Radio Plus nuk është e interferuar nga Radio Kosova e lirë, dhe as nga ndonjë frekuencë tjetër.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën nga ARKEP, sipas së cilës Top Iliria Radio është duke interferuar në brezin e aeronautikës. Pas matjeve në terren është konstatuar se Top Iliria Radio është duke interferuar dhe është urdhëruar që ta ndërprej transmetimin deri në evitimin e problemit.

Rastet për transmetime të pa licencuara

DMF gjatë vitit 2017 nga matjet në terren është konstatuar pranim i sinjalit DVB nga transmetuesit me mbulim nacional nga pika e Goleshit, dhe pas rekomandimeve të KPM-së këto transmetime janë ndërprerë.

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR

DMF gjatë vitit 2017 ka bërë edhe monitorime të radio frekuencave që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së dhënave që posedon KPM-ja. Gjatë vitit 2017, radiot e huaja ndërkombëtare BBC, VOA dhe RFI kanë vazhduar transmetimet e tyre. Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës. Vazhdon bashkëpunimi i KPM-së me KFOR për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it.

Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit

Gjatë vitit 2017 DMF ka proceduar me këto kërkesa të subjekteve transmetuese të licencuara për ndërrim të lokacionit të transmetimit:

1. Radio Maria (Prizren) - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit, i cili ka plotësuar kushtet për ndryshim të lokacionit;
2. Radio Maria (Obiliq) - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit, i cili ka plotësuar kushtet për ndryshim të lokacionit;
3. Radio K (Fushë Kosovë) - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit, i cili ka plotësuar kushtet për ndryshim të lokacionit;
4. Radio Dukagjini (Pejë) - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit, i cili ka plotësuar kushtet për ndryshim të lokacionit;
5. Radio Top Iliria (Deçan) - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit, i cili ka plotësuar kushtet për ndryshim të lokacionit;

Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë

Gjatë vitit 2017 TV regjionale si TV Besa, TV Prizreni, TV Ballkani kanë ndërprerë transmetimit tokësor, ku edhe pas njoftimeve (rekomandimeve) nga KPM-ja për fillim të transmetimit, nuk kanë filluar transmetimin. TV Iliria, TV Liria pas njoftimeve nga KPM-ja, kanë filluar transmetimin tokësor. TV Zoom, TV Tema, TV Liria dhe TV Vali kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë, dhe kanë marr rekomandime nga KPM që të veprojnë në pajtim me kushtet dhe termet e Licencës.

Kërkesë për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja

Gjatë vitit 2017 KPM ka ndarë dy frekuenca shtesë për Radio Dukagjinin, duke filluar kështu rritjen e zonës së mbulimit. Ka filluar transmetimin Radio Prishtina nga lokacioni i Vneshtave për mbulim të territorit të Prishtinës.

Plani frekuencor dhe digjitalizimi

Gjatë vitit 2017, DMF ka bërë përgatitjen e planit të frekuencave për transmetim tokësor televiziv digjital në Republikën e Kosovës, si obligim nga ligji për Digjitalizim në Republikën e Kosovës dhe ka bërë matje në terren lidhur me verifikimin e kanaleve të cilat janë ndarë nga ITU për transmetim digjital në territorin e Republikës së Kosovës. Nga këto matje është konstatuar se këto kanale nuk janë të interferuara nga vendet fqinjë. Gjatë vitit 2017, DMF ka punuar edhe në hartimin e draft të dosjes së tenderit për digjitalizim, përkatësisht pjesës teknike që do të vendosen në këtë dokument.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Komisioni i Pavarur i Mediave është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2017 janë bërë ndryshime lidhur me Buxhetin fillestar në raport me Buxhetin final. Buxheti fillestar paraqet buxhetin e aprovuar sipas Ligjit për ndarjet buxhetore, të ndarë sipas kategorive ekonomike. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, Buxheti fillestar në vlerë prej 1,214,275.99 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 764,275.99 euro.

Ky zvogëlim vjen si rezultat i mos realizimit të Projektit Kapital të “Ndërtimit të Objektivit të KPM-së” në vlerë prej 450,000.00 euro. Projekti i aprovuar për vitin 2017 nuk është realizuar, pasi që me datën 02.08.2017 Qeveria ka marr vendim me nr. 08/151, për reduktimin e projekteve kapitale.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2017, Komisioni i Pavarur i Mediave nga Buxheti final i ndarë në vlerë prej 764,275.99 euro ka shpenzuar buxhetin në vlerë prej 728,952.73 euro apo 95 %.

Buxheti i Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2017

<i>Kategoritë</i>	<i>Buxheti fillestar</i>	<i>Buxheti final</i>	<i>Buxheti i shpenzuar</i>	<i>Buxheti i pashpenzuar</i>
Pagat dhe mëditjet	388,291.99	388,291.99	370,498.58	17,793.41
Mallra dhe Shërbime	347,984.00	347,984.00	331,649.94	16,334.06
Shërbime Komunale	28,000.00	28,000.00	26,804.21	1,195.79
Projekte Kapitale	450,000.00	0.00	0.00	0.00
Total:	1,214,275.99	764,275.99	728,952.73	35,323.26

KPM në kategorinë e *pagave dhe mëditjeve* paraqet buxhetin e ndarë në vlerë prej 388,291.99 euro dhe buxhetin e shpenzuar të mjeteve në vlerë prej 370,498.58 euro apo 95%.

Në kategorinë e *mallrave dhe shërbimeve* paraqet buxhetin e ndarë në vlerë prej 347,984.00 euro. Vlera totale e shpenzuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 331,649.94 euro apo 95 %.

Në kategorinë e *shërbimeve komunale* paraqet buxhetin e ndarë në vlerë prej 28,000.00 euro. Vlera totale e shpenzuar në kategorinë e shërbimeve komunale është 26,804.21 euro apo 96 %.

Në kategorinë e *Projekteve kapitale*, gjatë periudhës Janar – dhjetor 2017, buxheti i ndarë në vlerë prej 450,000.00 euro për Projektin “Ndërtim i Objektivit të KPM-së” nuk është aprovuar. Për këtë projekt kanë qenë të ndara dhe të aprovuar mjetet për 3 (tri) vite dhe ato në vlerë 450,000.00 për vitin 2017, ndërsa 460,000.00 për vitin 2018 dhe 470,000.00 për vitin 2019. Me datën 15.05.2017 është lidhur Marrëveshja për Memorandum mirëkuptimin në mes KPM-së dhe MAP për bartjen e Projektit kapital (Ndërtimi i objektivit të KPM-së) nga KPM në MAP. Projekti i aprovuar për vitin 2017 nuk është realizuar, pasi që me datën 02.08.2017 Qeveria ka marr vendim me nr. 08/151, për reduktimin e projekteve kapitale.

Nga të hyrat vetanake të mbledhura prej KPM-së janë gjeneruar 206,362.02 euro, prej tyre 194,324.52 euro u takojnë të hyrave nga licenca ndërsa shuma prej 997.50 euro u takojnë të hyrave nga dënimet për

vonesën e pagesës së taksës dhe shuma prej 11,040.00 euro u takojnë të hyrave nga gjoba. Mjetet nga të hyrat shkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të arkëtueshmet nga Shërbimet audio-vizuale që nuk e kanë kryer obligimin e pagesës së tarifës për licencë për vitet paraprake (2011, 2012, 2013) dhe gjobat e viteve paraprake (vendimet sanksionuese që ka marr Bordi Ankesave për Media) janë të proceduara në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ndërsa Shërbimet audio-vizuale që nuk e kanë bërë pagesën e tarifës për licencë për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, KPM këto raste gjatë vitit 2017 i ka proceduar te përmbaruesi privat për ekzekutim. Të arkëtueshmet e KPM-së për vitin 2017 dhe vitet paraprake, janë në vlerë prej 545,239.00 euro. Si pasojë e mos pagesës së tarifës për Licencë nga të licencuarit e KPM-së, vitet e fundit të arkëtueshmet kanë qenë në rritje. Dhe për këtë arsye KPM ka bërë ndryshimin e Rregullores për mënyrën e pagesës së tarifës për licencë. Me hyrjen në fuqi të Rregullores KPM - 2017/03 (me datën 25.01.2017) për tarifën Vjetore për Licencë, shfuqizohet Rregullorja KPM – 2014/03. Rregullorja e re e KPM-së për mënyrën e pagesës së tarifës së licencës, rregullon ato mangësi të gjetura në rregulloren e vjetër. Zbritja e shumave të tarifës për licencë, shtyrja e afatit për pagesën e tarifës dhe po ashtu procedimi i rasteve te përmbaruesi do të ketë ndikim në zvogëlimin e borxheve ndaj KPM-së. Në Shtojcën IIIa është dhënë Raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

PUNA E BORDIT PËR ANKESA

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit për KPM-në. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa, Kuvendi zgjedh Kryetarin. Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

Emërimi i një anëtari të Bordit për Ankesa

Në seancën e mbajtur më 27 shkurt 2017, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit të Ankesave dhe ka emëruar znj. DUA KADRIU, për anëtarë të Bordit për Ankesa, me mandat 3 vite, siç parashihet me nenin 40, paragrafin 1, të Ligjit për KPM-në Nr. 04/L-44. Bordi i Ankesave nga muaj korrik 2017 nuk ka qenë në përbërje të plotë për shkak të anëtarja e Bordit znj. KADRIU, ka ndërruar jetë me 7 korrik 2017. Procedurat e emërimit të një anëtari të Bordit për Ankesa është duke i zhvilluar Kuvendi i Republikës së Kosovës, sipas Ligjit për KPM-në.

Përbërja e Bordit gjatë vitit 2017

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Avdyl	HYSENI	Kryetar	16 qershor 2016	mandat 3 (tre) vjeçar
Musa	DRAGUSH	Anëtar	16 qershor 2016	mandat 3 (tre) vjeçar
Dua	KADRIU	Anëtare	22 shkurt 2017	deri më 7 korrik 2017 kur është nda nga jeta

Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa (BA) gjatë vitit 2017 ka mbajtur tri (3) seanca dy (2) nga këto shqyrtuese ku ka shqyrtuar katër (4) ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa në një seancë të veçanet ka vendosur për ndryshim plotësimin e Rregullores së Punës në pajtim me nenin 42 të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44.

Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e Bordit për Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së gjatë vitit 2017 janë si në vijim:

1. Ankesa e operatorit të shpërndarjes IPKO Telecommunication LLC e parashtruar me datën 20 shkurt 2017. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 20 mars 2017 vendosi të hudh poshtë ankesën e IPKO-së për shkak të mungesës së kompetencës lëndore.
2. Ankesa e televizionit publik RTK 1 e parashtruar më datën 29 nëntor 2016. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 18 prill 2017 vendosi të refuzojë si të pa bazuar ankesën e RTK 1 dhe e vërtetojë Vendimin me Vërejtje të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së, për shkelje të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01.
3. Ankesa e Top Kosova Radio e parashtruar me datën 29 nëntor 2016. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 18 prill 2017 vendosi të refuzojë si të pa bazuar ankesën e Top Kosova Radio dhe e vërtetojë Vendimin e KPM-së për mospërtëritje të licencës. .
4. Ankesa e z. Arben Visoqi e parashtruar me datën 29 nëntor 2016. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 18 prill 2017 vendosi të aprovojë pjesërisht ankesën dhe në të njëjtën kohë konstatojë së pretendimi i palës ankuese për shkelje të Kodit të Etikes nga transmetuesi është i pa bazuar.

OBJEKTIVAT E VITIT 2017

Edhe gjatë vitit 2017 Komisioni i Pavarur i Mediave ka vazhduar punën në përmbushjen e objektivave të parapara e që janë implementimi i procesit të dixhitalizimit, respektivisht hartimi dhe miratimi i legjislacionit të ri sekondar, pastaj amandamentimi i një pjese të legjislacionit aktual sekondar bazuar në obligimet ligjore nga Ligji i KPM dhe Ligji për Digjitalizimin e Transmetimeve Tokësore Radio Difuzive. Politikat e KPM-së janë të tilla që krijojnë mundësi në diversitet dhe pluralizëm medial, që i shërbejnë gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. KPM, në vitin 2017, ka lëshuar licenca të reja për shërbime mediale audio me frekuenca lokale në mënyrë që të ofrohet qasje në informim qytetarëve, në zonat ku ka pasur mungesë të këtyre shërbimeve. KPM ka krijuar bazën ligjore edhe për zhvillimin e ofertave të reja përmes platformave të reja si: IPTV, OTT dhe të tjera si dhe zhvillimi i ofertave të reja programore përmes platformave të operatorëve të shpërndarjes.

OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2018

Bazuar në obligimet ligjore dhe vazhdimësinë e punës së institucionit, në vitin 2018 KPM do të fokusohet në disa objektiva:

1. Reformimi i kornizës ligjore

- Hartimi i rregullores për pronësinë e mediave dhe parandalimin e koncentrimin të mediave;
- Hartimi i pakos së licencës për operatorë të MUX;
- Hartimi i pakos së licencës për OSHMA përmes MUX dhe rregullores për vlerësimin e aplikacioneve për këta të licencuar; dhe
- Plotësimi i rregullores për taksën për licencë.

2. Implementimi i digjitalizimit në nivel shtetëror

- Përgatitja dhe shpallja e tenderit për kanalet 46 dhe 58.

3. Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”

- Definimi dhe hartimi i udhëzuesit relevant;
- Përcaktimi i roleve/obligimeve/përgjegjësi;
- Krijimi i një platforme ndërinstucionale për promovim dhe zhvillim;
- Planifikimi i aktiviteteve.

4. Fuqizimi i komunikimit me publikun dhe promovimi i punës së KPM-së

- Komunikim dhe angazhim përmes takimeve dhe fushatave informuese
- Lansimi i webfaqes së re për qasje më të lehtë të publikut në punën transparente të KPM-së. Përmes webfaqes së re synohet edhe krijimi i një komunikimi publik elektronik për çështje të rëndësishme siç janë liria e shprehjes dhe mediat e reja, lajmet e rrejshme dhe përmbajtjet programore në përgjithësi.

5. Hulumtime dhe analiza

- Analiza e tregut medial;
- Hulumtim për shikueshmërinë dhe dëgjueshmërinë.

6. Identifikim i mangësive aktuale në zbatimin e legjislacionit primar

- Ligji i KPM-së
- Rregulloret e KPM-së

7. Promovimi dhe mbrojtja e së drejtës së autorit

8. Ristrukturimi i Zyrës Ekzekutive

REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT (problemet me buxhetin, rritja e numrit të stafit)

Problemet me buxhetin

Shkurtime të buxhetore që KPM ka pasur vazhdimisht, po pamundësojnë funksionimin tonë si një institucion i pavarur dhe po rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme.

Nevoja për punëtorë të rinj

Për disa vjet radhazi, KPM kërkon shtimin e stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërliken me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM është rritur dukshëm dhe se shtimi i volumit të detyrave për nëpunësit ekzistues është trefishuar. KPM-ja ka paraqit kërkesa në vazhdimësi dhe ende nuk është aprovuar kjo rritje e numrit të punëtorëve. Aktualisht jemi duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësoj edhe punën e KPM-së në zbatimin e ligjit të KPM-së dhe atij për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore.

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2016

Plani i Veprimit të Menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it

Nr	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1	Rekomandimi nr. 1 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të forcohen kontrollat në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, përfshirë edhe raportimin e	KPM-ja ka ndërmarr veprimet e nevojshme për prezantimin e pasurisë jo financiare. Për vitin 2016 nuk është prezantuar vlera neto sepse nuk është bërë amortizimi me kohë nga ASHI mirëpo është bërë shpalosja në PVF me sqarim lidhur me këtë. KPM-ja ka kërkuar nga ASHI që të bëhet amortizimi që nga data 13.10.2016 dhe kjo kërkesë është bërë në vazhdimësi edhe me telefon dhe email. Emaili i fundit për amortizimin e pasurive nën 1000 euro është dërguar nga ne më datën 31.01.2017. Me datën 02.02.2017 është bërë amortizimi nga ana e ASHI-t dhe e kanë dërguar. Do të thotë që ata e kanë bërë pas dorëzimit të PVF 2016, e cila është dorëzuar më 30.1.2017.	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave

	tyre në PVF.	<p>KPM-ja pas amortizimit nga ana e ASHI i ka prezentuar të dhënat edhe në raportin e inventarizimit të pasurive duke përfshirë në raport edhe pasuritë mbi 1000 edhe nën 1000 euro.</p> <p>Sa i përket këtij rekomandimi neve Auditori Gjeneral na ka njoftuar pas auditivit. Duhet cekur që këtë vit auditimi është bërë më vonë se zakonisht dhe kur jemi njoftuar se është dashur të bëhet korigjimi i PVF ka qenë e pamundur ngase afati për korigjime në PVF është vetëm deri më 31.03.2017.</p>		
2	<p>Rekomandimi nr. 2</p> <p>Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve kohore, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.</p>	<p>Lidhur me këtë rekomandim, KPM-ja ka ndërmarr këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ka ndryshuar Rregulloren për Tarifën Vjetore të Licencës (më 31.12.2014 dhe më 25.01.2017 (në pajtim me Ligjin e KPM-së). - Rastet për subjektet të cilat deri në vitin 2013 nuk kanë paguar tarifën për licencë i ka dërguar në Gjykatën Themelore për Çështje Ekonomike kurse rastet për mospagesë për vitet 2014 dhe 2015 janë proceduar përmes Përmbauesve privat. <p>Këto veprime janë ndërmarrë për të siguruar gjenerim sa më të mirë të të hyrave nga tarifa e licencës mirëpo nuk ka qenë pastaj gjithçka e varur nga KPM për faktin që këto veprime nga institucionet tjera po marrin kohë deri në finalizimin e lëndëve.</p> <p>Sa i përket pagesës nga kategoria jo adekuate, bazuar në rekomandimin paraprak nga Auditori Gjeneral ne kemi ndjekur procedurën e paraparë duke bërë kërkësa në MF (2 herë radhazi) lidhur me këtë çështje. Pavarësisht urgjencës së paraqitur, MF nuk ka marrë në konsideratë kërkesën dhe ne jemi detyruar të bëjmë këtë veprim me qëllim që të mos dështojë sistemi i monitorimit dhe serverët.</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave
3	<p>Rekomandimi nr. 3</p> <p>Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se është analizuar plotësimi i pyetësorit të vet-</p>	<p>KPM ka përgatitur listën e rreziqeve pasi që ka pranuar formën standarte të menaxhimit të rrezikut. Lista e rreziqeve është hartuar me vonesë për faktin që NjQH ka organizuar trajnimin adekuat për menaxhim të rrezikut tek në fund të vitit, respektivisht</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave

	<p>vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të parandalohen rreziqet të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.</p>	në muajin dhjetor 2016.		
4	<p>Rekomandimi nr. 4 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të shtoj kontrollet për arkëtimin me kohë të të hyrave në bazë të planifikimit vjetor dhe legjislacionit, si dhe të filloj të ekzekutoj sanksionet në rast të mos pagesës me kohë të tarifave.</p>	<p>Në vitet e mëparshme, afati i fundit për pagesën vjetore të tarifës së licencës ka qenë 31 janari, ndërsa vonesat në kryerjen e këtij obligimi kanë rezultuar me pagesë shtesë, që do të thotë kamatë e cila është përcaktuar sipas Ligjit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Në bazë të përvojave në të kaluarën kjo ka bërë që të arkëtueshmet të rriten edhe më shumë, andaj Komisioni i Pavarur i Media (KPM) ka bërë ndryshimin e Rregullores. Në fund të vitit 2014 me qëllim të harmonizimit të Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës për Licencë Nr. KKPM-2010/02 me Ligjin e ri të KPM-së Nr. 04/L-44 si dhe duke u bazuar në nenin 26, paragrafi 3 të këtij Ligji, KPM ka bërë amendamentimin e Rregullores Nr. KKPM-2010/02, duke e zëvendësuar me Rregulloren KPM-2014/03. Rregullorja KPM-2014/03 nuk ka reflektuar ndryshime në nivelin e pagesës së taksës vjetore të licencave (për të gjitha kategoritë e të licencuarve të KPM-së), e ka zgjatur afatin e pagesës deri në fund të tremujorit të parë të vitit dhe nuk ka përcaktuar më aplikim të kamatës në vonesa. Qëllimi i KPM-se ka qenë mbledhja e të hyrave dhe zvogëlimi i të arkëtueshemeve. Në këtë rast, KPM-ja duke parë që edhe me ndryshimin e Rregullores problemet me pagesën e taksës kanë vazhduar, ka ndërmarr hapa duke bërë ndryshimin tek shumat për të cilat obligohen të licencuarit të paguajnë duke i përgjysmuar ato në Rregulloren këtij viti (2017) për Tarifën</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave

		<p>Vjetore të KPM-së dhe duke shtyrë afatin për pagesën e taksës.</p> <p>Tarifa vjetore për licencë për të gjitha kategoritë e të Licencuarve të KPM-së, do të depozitohet në tërësi në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur të Mediave deri më 30 qershor të vitit 2017.</p> <p>Arsyeja pse të arkëtueshmet janë rritur në vitin 2016 ka qenë pasi që Gjykata nuk i ka pranuar më lëndët dhe procedurat për përmbarues kanë zgjatur shumë. Tani këto lëndë KPM-ja i ka të proceduara tek Përmbaruesi privat.</p> <p>Arsyeja kryesore për vonesat e taksës ka qenë mos pagesa me kohë e të licencuarve me arsyetimin se për shkak të kushteve ekonomike të licencuarit nuk kanë arritur të kryejnë obligimin me kohë. Kjo gjendje reflektohet edhe në raportet vjetore të të licencuarve. Duke pas parasysh se një numër i madh i të licencuarve të KPM-së (përfshirë këtu edhe mediat që transmetojnë në gjuhë të komuniteteve në Kosovë) nuk kanë kryer obligimin e pagesës, KPM ka konsideruar se masa e fundit e sanksionimit (revokimi i licencës në këtë rast) do të kishte efekt negativ për publikun, respektivisht në cenimin e të drejtës për informim e pluralizëm medial. Lidhur me këtë, KPM ka marrë vendime për shtyrje të afatit me qëllim që të licencuarve t'u ofrohet mundësia e kryerjes së obligimit e në anën tjetër edhe publiku të mos privohet nga e drejta për informim dhe pluralizëm medial.</p>		
5	<p>Rekomandimi nr. 5</p> <p>Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të ndërmerri veprime për të ndërprerë praktikën e mbulimit të pozitive me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas</p>	<p>Drejtori i Departamentit ligjor nga data 01.12.2015 fillimisht ka qenë në pushim pa pagesë e pastaj edhe ka dhënë dorëheqje, si dhe duke pas parasysh se puna në këtë departament ka qenë mëse e domosdoshme që të mos ndërpritet deri në përfundim të procedurave të rekrutimit është ndjekur procedura e paraparë me Ligjin për Shërbyesit Civilë për caktimin e Ushtruesit të Detyrës.</p> <p>Më datë 01.01.2016 mbas dorëheqjes së drejtorit të Departamentit Ligjor, Zyra Ekzekutive ka bërë kërkesën në MAP për fillim të procedurave të rekrutimit mirëpo për shkak që MAP me shumë vonesë ka</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave

	përcaktimit ligjor.	<p>dhënë miratimin, nuk ka qenë e mundur të shpallet konkursi në afatin e paraparë, rrjedhimisht është imponuar vazhdimi i kontratës për Ushtrues Detyre. Shpallja e konkursit për pozitën e lartëpërmendur është bërë menjëherë pas aprovimit nga MAP mirëpo konkursi është anuluar nga ana e KPMSHC-së. KPM për herën e dytë ka përsëritur konkursin dhe pas përfundimit të procedurave të rekrutimit në dhjetor të vitit 2016 është emëruar Drejtori i Departamentit Ligjor.</p> <p>Në rastin e dytë është bërë caktimi i Ushtruesit të Detyrës për pozitën e Zyrtarit të Lartë për Marrëdhënie me Publikun nga data 1 prill 2016 deri më 31 dhjetor 2016 kur Zyrtarja e Lartë për Marrëdhënie me Publikun ka qenë në pushim të lehonisë. Ka qenë domosdoshmëri që të caktohet dikush nga stafi për të siguruar që nuk ndërpritet komunikimi me media dhe me institucionet tjera dhe që faqja zyrtare e KPM-së menaxhohet nga stafi i brendshëm për të evituar çfarëdo problemi. Komunikimi me media është një ndër elementet më të rëndësishme në kryerjen e misionit të KPM-së së bashku edhe me korrektësinë që duhet treguar në dhënjën e përgjigjeve kundrejt kërkesave që vijnë nga publiku dhe të tjerë dhe në mungesë të Zyrtares përgjegjëse sipas detyrës zyrtare për kohën sa ka qenë në pushim të lehonisë, është imponuar e kushtëzuar që këto detyra të mbulohen duke caktuar U.D. bazuar në Nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.</p>		
6	Rekomandimi nr. 6 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet siguruar që shpenzimet buxhetohen drejtë sipas kategorive ekonomike, si dhe blerjet/pagesat kryhen dhe evidentohen në kategoria adekuate me qëllim të	<p>KPM-ja ka qenë e detyruar të ndërmarr këtë veprim pas shumë kërkesave të dërguara në MF-së për transfer të mjeteve nga mallrat dhe shërbimet në kategorinë e projekteve kapitale si dhe aprovimin në projektin ekzistues “Arkiva Elektronike”.</p> <p>Pavarësisht sqarimeve që i kemi dhënë MF-së për të kuptuar se sa po rrezikohet puna e KPM-së nëse nuk do të ndërmerreshin veprimet që janë ndërmarrë, ne kemi marrë përgjigje negative nga MF dhe fatkeqësisht kjo qasje e refuzimit edhe në rastet më</p>	Janë marr masat që në të ardhmen në raste të tilla të bëhet transferi nga një kategori në tjetrën.	Komisioni i Pavarur i Mediave

	shpalosjes së drejtë të shpenzimeve në PFV.	<p>urgjente kur rrezikohet puna e një institucionit po vazhdon duke na sjell në situatë që ose të humbim pajisjet për të cilat është investuar shumë (nga shteti dhe nga donatorët) dhe të cilat janë të domosdoshme që KPM të përmbush obligimet ligjore ose të ndërmarrim veprimet të cilat me të drejtë mund të interpretohen që nuk janë realizuar tërësisht sipas procedurave të parapara.</p> <p>KPM duhet të bëjë monitorimin e mediave dhe të bëjë arkivimin e materialeve audiovizuale të transmetuara nga mediat dhe këtë e bën përmes sistemit të monitorimit të krijuar vetëm këtë qëllim. Për shkak të specifikave të këtij sistemi, nuk mund të ketë parashikime se cka mund të dështojë ose të dalë si nevojë në mënyrë që të bëhën planifikime vjetore në avans. Prandaj, për rastin në fjalë ka lind një problem që jo vetëm e ka pamundësuar monitorimin ditor si edhe të periudhës së zgjedhjeve komunale në Drenas por ka rrezikuar tërë sistemin i cili ka vlerë shumë të madhe.</p> <p>Me zgjidhjen e problemit (edhe pse pa miratimin e MF) ne kemi siguruar që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. nuk i kemi humbur pajisjet e monitorimit, rrjedhimisht që sistemi i monitorimit nuk ka dështuar, dhe 2. kemi realizuar obligimin që na është dhënë me ligj për monitorimin e përmbajtjeve programore. 		
7	<p>Rekomandimi nr. 7</p> <p>Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara do të bëhet në përputhje me rregulloren 02/2013 për raportimin e</p>	<p>Për arsye të vonësës të alokimit të buxhetit për vitin 2016, detyrimet (faturat) që janë krijuar / pranuar deri me 31 dhjetor 2015 nuk janë paguar në Janar 2016 dhe për këtë arsye janë paguar në fillim të muajit Shkurt 2016. Detyrimet (faturat) e pranuar janë raportuar në Raportin vjetor 2015 dhe janë raportuar në Raportimin e faturave të papaguara Dhjetor 2015 që raportohet deri me datën 15.01.2016. Për këtë arsye logjika e Raportimit ka qenë që Faturat e Papaguara të vitit paraprak të mos prezentohen në</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave

	obligimeve të papaguara. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore.	Raportin e Obligimeve në Janar 2016, pasi që janë paguar para datës 15.02.2016. Për vitin tjetër e kemi të qartë që të gjitha faturat do të prezentohen me kohë. Dhe se faturat e papaguara të vitit paraprak janë paguar dhe gjithmonë do të paguhen me prioritet dhe njëkohësisht duke shpresuar se alokimi i buxhetit bëhet me kohë.		
--	---	---	--	--

Rekomandimet nga Raporti i Auditimit të ZAP-it

Rekomandimi 1 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të forcohen kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, përfshirë edhe raportimin e tyre në PVF.

Rekomandimi 2 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve kohore, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se është analizuar plotësisht i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të parandalohen rreziqet të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 4 Kryetari i komisionit të KPM-së duhet të shtoj kontrollet për arkëtimin me kohë të të hyrave në bazë të planifikimit vjetor dhe legjislacionit, si dhe të filloj të ekzekutoj sanksionet në rast të mos pagesës me kohë të tarifave.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të ndërmerr veprime për të ndërprerë praktikatat e mbulimit të pozitave me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas përcaktimit ligjor.

Rekomandimi 6 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet siguruar që shpenzimet buxhetohen drejtë sipas kategorive ekonomike, si dhe blerjet/pagesat kryhen dhe evidentohen në kategoria adekuate me qëllim të shpalosjes së drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi 7 Kryetari i Komisionit të KPM-së duhet të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara do të bëhet në përputhje me rregulloren 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore.